

KODI I ETIKËS



Rr "Todi Shkurti", P. 4, H. 21 Ap.34, Tiranë ALBANIA.

E-mail: gendra@infocipl.org

websites: www.inforcip.org dhe www.vemdime.al

PARATHËNIE

PREAMBULA

Qendra për Çështje të Informimit Publik, INFOÇIP, krijuar në 22/09/2004, është institut jo-qeveritar, i tipit think-tank, me një vokacion të fortë për vlerësime ligjore, monitorim dhe advokaci. Misioni i INFOÇIP është të promovojë Qeverisjen e Mirë dhe Zbatimin e Ligjit. Orgenet drejtuese të Qendres janë Bordi vendimares dhe Drejtori Ekzekutiv.

INFOÇIP i dedikohet rritjes së aksesit të publikut në shërbime, në vendimarrje, në legjislacion dhe në dokumentat zyrtare. Ne ndajmë besimin se një qytetar i informuar mbi normat qeverisese dhe shërbimet që i ofrohen kundrejt taksave që paguan është një qytetar më i mirë.

INFOÇIP e parafytyron rolin e vet si një lupë në duart e publikut për të parë më mirë brenda institucioneve shtetërore. Logo e Qendrës vizualizon këtë parafytyrim: një lupë e stilizuar e vendosur mbi një strukturë trekëndëshe, që simbolizon tre pushtetet: Legjislativin, Ekzekutivin dhe Gjyqësorin. Kjo strukturë trekëndore e pushtetit shtetëror është e përmbysur, me bazën sipër dhe majën e piramidës poshtë, për të theksuar ripërcaktimin e autoritetit në kontekstin e shoqërive të hapura, ku informacioni nuk është më privilegj i disave, por aset publik në dispozicion të të gjithëve dhe rrjedhimisht një *enzimë* e pazëvendësueshme për funksionimin e demokracisë.

KODI I ETIKËS

Nëpërmjet pranimit të parimeve të këtij Kodi Etik, anëtarët e INFOCIP angazhohen me vullnetin e tyre të lirë të mbrojnë vlerat dhe principet e lirisë, integritetit, barazisë, tolerancës, diversitetit, respektit, përgjegjshmërisë, transparencës dhe profesionalizmit.

Kodi është një grupim standartesh që përgjithësisht adreson: qeverisjen e INFOCIP, manaxhimin financiar, aspektin e transparencës ndaj anëtarëve dhe publikut, sistemin e llogaridhënies, marrëdhëniet me mbështetësit dhe donatorët, adresimin e konfliktit të interesave, etj. Kodi është një mekanizëm vetërregullues që hartohet mbi vullnetin e lirë të grupit, cilido qoftë ky.

INFOCIP funksionon në përputhje me aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë, si dhe në respekt të parimeve dhe rregullave të shkruara në aktet e etimelimit dhe regjistrimit të organizatës.

Ky kod i bashkalidhet akteve të organizatës. Aty ku këto të fundit janë të heshtura, pervalojnë parimet dhe rregullat e këtij Kodi.

QËLLIMI I KODIT

1. Kodi i Etikës siguron transparencë dhe përgjegjshmëri në funksionimin e INFOCIP, mbi baza vullnetare dhe vet-rregulluese;
2. Përmirëson cilësinë e shërbimeve ofruar nga INFOCIP duke aplikuar standarte të larta të etikës dhe sjelljes, si dhe procedura më efektive vendim-marrëse;
3. Përmirëson komunikimin midis anëtarëve të INFOCIP si dhe mes tyre e aktorëve të tjerë;
4. Përmirëson performancën e INFOCIP duke nxitur shkëmbimin e eksperiencës mes anëtarëve të saj e duke mësuar nga praktikatat më të mira.

PARIMET UDHËHEQËSE TË KODIT TË ETIKËS SË INFOCIP

Në vijim janë listuar parimet kryesore në të cilat anëtarët e INFOCIP duhet të bazohen brenda kuadrit të Kodit të Etikës dhe respektimit të tij. Keto parime janë ndarë në dy kategori kryesore:

1. Parime të Marrëdhëniet të Brendshme;
2. Parime të Marrëdhëniet të Jashtme.

PARIME TË MARRËDHËNIEVE TË BRENDSHME

➤ QEVERISJA E MIRË

Qeverisje e mirë është procesi nëpërmjet të cilit Bordi dhe trupa ekzekutive është duke punuar / ecur në mënyrën efektive dhe të duhur. Parimi i qeverisjes së mirë demokratike është pranuar në nivel Bordi. Këto parime zbatohen mbi disa angazhime;

1. Angazhimit të INFOCIP për të zbatuar procedura të qeverisjes dhe rregullat e sjelljes.
2. Angazhimit të INFOCIP për të qenë e pavarur nga çdo forcë / parti politike;
3. Angazhimit të INFOCIP për të qenë transparente dhe e përgjegjshme ndaj të gjithë mbështetësve;
4. Angazhimit të INFOCIP për të siguruar dhe respektuar të drejtat e punonjësve.
5. Angazhimit të INFOCIP për të punuar me përfituesit e saj mbi bazën e gjithëpërfshirjes, ndershmërisë dhe mos-diskriminimit.

➤ PAVARESIA DHE VLERESIMI

INFOCIP merr vendime dhe vepron në mënyrë të pavarur, jashtë ndikimit të partive politike apo kompanive private. Veprimtaria e INFOCIP bazohet në misionin e saj. Aktivitetet e organizatës monitorohen nga Bordi dhe vlerësohen rregullisht për të siguruar përputhjen e saj me misionin për të cilin është krijuar.

➤ MISIONI

Qëllimi i organizatës, i vendosur dhe i aprovuar nga bordi i drejtuesve, shpallet formalisht dhe specifikisht. Aktivitetet e INFOCIP janë në përputhje me qëllimin e përcaktuar në statut dhe aktet e tjera të organizimit dhe funksionimit të organizatës.

INFOCIP duhet të vlerësoj nëse misioni ka nevojë të modifikohet për të reflektuar ndryshimet e shoqërisë, nëse programet e saj aktuale duhet të rishikohen ose ndërpriten, ose nëse duhen zhvilluar programe të reja gjithmonë brenda fokusit të saj të veprimtarisë dhe qëllimit të krijimit të saj.

➤ SHËRBIMI ME PROFESIONALIZËM

Në kryerjen e programeve dhe shërbimeve të saj, INFOCIP vepron me një profesionalizëm të plotë dhe trajton me respekt personat të cilëve i'u shërben. Kur është e nevojshme, INFOCIP përcakton politika që mbrojnë konfidencialitetin e informacionit personal, kur kjo është e nevojshme..

➤ INTEGRITETI

Anëtarët e INFOCIP nuk duhet të kryejnë veprime të cilat kanë për qëllim denigrimin e agjencive të tjera apo të bëjnë deklarata publike të pavërteta ndaj agjencive të tjera.

Bordi dhe anëtarët e e INFOCIP duhet të veprojnë në të mirë të interesave të organizatës, dhe jo në plotësim të interesave personale apo interesave të një pale të tretë.

INFOCIP ka politika të qarta dhe duhet t'i zbatojë sistematikisht këto politika në mënyrë që të parandalojë konflikte e mundshme të interesave. Kjo politikë duhet të aplikohet nga anëtarët e bordit, stafit dhe vullnetarët të cilët kanë autoritet të pavarur në marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me burimet e organizatës.

Një përmbledhje e rregullave bazë në lidhje me shmangien e konfliktit të interesave në nivel Bordi përfshin:

1. N.q.s një anëtar i Bordit ka ndonjë interes tjetër (jo primar por është i përfshirë, për rrethana të ndryshme) i cili nuk përbën rrezik për mbarëvajtjen e procesit por mund të çojë arsyeshëm të tjerët të mendojnë që mund të influencojë vendimin në favor të tij, anëtari i Bordit duhet të deklarojë natyrën e interesit dhe t'i lerë anëtarët e tjerë të bordit të vendosin nëse ai duhet të përfshihet apo jo në procesin vendim-marrës.
2. Asnjë anëtar nuk duhet të ketë më shumë se sa një pozicion në strukturën e INFOCIP, ose të jetë anëtar stafi dhe Bordi në të njëjtën kohë.
3. Anëtarët e INFOCIP duhet të deklarojnë në çdo rast aspekte të cilat kanë të bëjnë me Konfliktin e Interesave.

➤ PRAKTIKAT E PERSONELIT DHE TE MENAXHIMIT

Vullnetarët dhe profesionistët e rinj, entuzistët e shtetit të drejtës dhe parimeve të shtetit demokratik, zënë një vend të veçantë në INFOCIP, duke shërbyer në qeverisje, administratë dhe në programim.

Politikat e INFOCIP me burimet njerëzore përfshijnë punonjësit me pagesë ashtu edhe vullnetarët dhe duhet të jenë të drejta, të përcaktojnë qartë pozicionet dhe detyrat si dhe të sigurojnë vlerësimin e kryerjes së detyrave në mënyrë kuptimplote dhe efektive. .

➤ ORIENTIMI I TË PUNËSUARIT

Punonjësit e rinj të organizatës duhet të marrin një orientim të detajuar të detyrave dhe pritshmërive profesionale ndaj tyre; kjo përfshin edhe një prezantim të Standarteve të parashikuara në Kodin e Etikës. Një pjesë e parimeve të këtij Kodi inkorporohen dhe futen direkt në veprim në kontratë të tyre të punës apo të shërbimit .

➤ **MOSDISKRIMINIMI**

Diskriminimi lind në çfarëdo situatë ku një individ apo grup njerëzish trajtohen në mënyrë jo drejtë / të pafavorizuar bazuar në përkatësinë e tyre gjinore, raciale, etnike, fetare, politike, moshore, shtresës së cilës i përkasin, apo aftësisë së tyre të kufizuar fizike dhe mendore.

INFOCIP duhet të marrin iniciativën dhe leadershipin për të asistuar dhe organizuar të gjithë njerëzit bazuar në parimin e barazisë dhe mundësive të barabarta.

Në punën e saj me përfituesit dhe në vendim-marrjen e brendshme, veçanërisht në rekrutimin, vlerësimin e stafit dhe sjelljen në organizatë, INFOCIP nuk duhet të diskriminojë individët bazuar në përkatësinë gjinore, fetare, etnike, aftësive të kufizuara, apo bindjeve politike.

PARIME TE MARRËDHËNIEVE TË JASHTME

➤ **PËRGJEGJSHMËRI NDAJ TË GJITHË MBËSHTETËSVE DHE PËRFITUESVE TË VEPRIMTARISË SË INFOCIP-S.**

Përgjegjshmëri do të thotë të jesh i aftë të sigurosh një shpjegim për veprimet a sjelljet e INFOCIP-s a të një përfaqësuesi të saj mbi çfarëdo lloj çështje.

➤ **TRANSPARENCA E AKTIVITETEVE TE INFOCIP-SE DHE KOMUNIKIMI**

Transparencë do të thotë të jesh i hapur mbi vendim-marrjen në organizatë dhe mbi punën e marrëdhënien me antarët, përfituesit, donatorët, qeverinë, organizatat dhe institucione të tjera, si dhe publikun e gjerë. Literatura e printuar (botime, materiale njohëse, raportuese) prezencë dhe mbulimi në media dhe ëbsite, duhet të komunikojnë dhe t'i sigurojnë çdo personi, organizatë a institucioni të interesuar informacionin si më poshtë:

1. Misionin e INFOCIP-s, objektivat dhe vlerat mbi të cilat ajo vepron;
2. Parimet e INFOCIP-s;
3. Metodologjinë e punës së saj, aktivitetet dhe arritjet, përfshirë këtu vlerësime dhe analiza të organizatës;
4. Fushën gjeografike të veprimit brenda Shqipërisë ose jashtë saj;
5. Strukturën e saj organizative dhe mënyrën e qeverisjes dhe të manaxhimit;
6. INFOCIP duhet t'i japi mundësinë çdo personi që shpreh interes në çështjet e organizatës që të komunikojë me një përfaqësues të saj.

➤ **TRANSPARENCA FINANCIARE**

INFOCIP duhet të praktikojnë metoda manaxhimi financiar të kohës dhe të punojnë në përputhje me një gamë të gjerë kërkesash ligjore dhe rregulluese. Sistemi financiar i INFOCIP-s duhet të sigurojë regjistrimin e të dhënave financiare dhe të dhëna që vërtetojnë që burimet financiare të organizatës janë përdorur për plotësimin e qëllimeve jo-fitimprurëse të organizatës. INFOCIP duhet të kryejnë rishikime periodike për të adresuar probleme të ndryshme në lidhje me rregulloren dhe përgjegjshmëritë.

➤ **PËRGJEGJËSIA FINANCIARE**

1. INFOCIP duhet të përgatisë dhe ruajë raporte financiare në baza kohore që pasqyrojnë me hollësi aktivitetin financiar të organizatës.
2. Korrektësia e raportimeve financiare duhet t'i jepet për egzaminim një Llogaritari Publik të Aprovuar (Audit) të paktën njëherë në vit, përmes auditimit direkt ose hartimit të bilancit financiar.
3. INFOCIP duhet t'i sigurojnë të punësuarve një mënyrë konfidenciale për të raportuar pa-korrektësi të dyshuara financiare ose keq përdorim të burimeve të organizatës.

➤ **PËRGJEGJËSIA DHE MARRËVESHJA LIGJORE**

INFOCIP duhet të njoh dhe të veprojnë në përputhje me ligjet e shtetit shqiptar. Kjo mund të përfshijë, por nuk është e kufizuar në aktivitetet e mëposhtme: respektimin e ligjeve dhe rregullave që janë të lidhura me ngritjen e fondeve, liçensimin, përgjegjësinë financiare, burimet njerëzore, lobimin dhe përkrahjen politike dhe taksat.

INFOCIP duhet të kryejnë periodikisht një rishikim të brendshëm të përshtatjes së organizatës me kërkesa të njohura raportuese ligjore, rregullatore dhe financiare dhe duhet t'u paraqesë një përmbledhje të rezultateve të këtij rishikimi anëtarëve të bordit të drejtuesve.

➤ **PJESEMARRJA DHE PARTNERITETI**

INFOCIP njihet nevojën për ngritjen dhe forcimin e partneriteteve të qëndrueshme bazuar mbi barazinë, besimin dhe ndershmërinë. Mbështetësit dhe partnerët janë një pjesë e mirë e shoqërisë / terrenit në të cilin INFOCIP operon. Për një punë dhe produkt sa më efektiv:

1. INFOCIP duhet të angazhohet për të zhvilluar procese konsultimi të vazhdueshme me mbështetësit. Kultura e konsultimeve të vazhdueshme është e rëndësishme për të qenë në kontakt dhe komunikuar me përfituesit, qeverinë, sektorë të tjerë (privat), organizata të tjera dhe për të qenë sa më transparent.

2. INFOCIP duhet të angazhohet në zhvillimin e partneriteteve me mbështetësit. Sa më shumë punë e koordinuar dhe në partneritet të bëhet nga INFOCIP aq më pak dublikime të aktivteteve do të realizohen
3. INFOCIP duhet të respektoj angazhimet e ndërmarra karshi gjithë mbështetësve, përfituesve dhe partnerëve të saj dhe duhet të njoh dhe respektoj autorësinë e ideve të tjerëve në sektor.
4. INFOCIP duhet të respektoj vlerat institucionale individuale, politikat, vizionet dhe objektivat si dhe të punoj së bashku me organizatat e tjera për të gjetur zgjidhje në lidhje me problematika diverse e për të arritur qëllime madhore nëpërmjet aftësive dhe eksperiencave komplementare dhe diverse.

➤ **TOLERANCA**

INFOCIP duhet të jetë e gatshme për të dëgjuar e konsideruar ide të reja dhe të ndryshme nga të tyret në mënyrë që të ecet së bashku drejt përmbushjes së qëllimeve.

INFOCIP duhet të pranojnë diversitetin e të menduarit si dhe ndryshimet midis organizatave të ndryshme, qëllimeve që ato kanë e veprimtarisë që kryejnë.

➤ **RRJETET, KOORDINIMI, BASHKËPUNIMI DHE KOMUNIKIMI**

Rrjetet, koordinimi, bashkëpunimi dhe komunikimi midis INFOCIP dhe organizatave të tjera bazohet në vlera dhe vizion të përbashkët. INFOCIP angazhohet për të përmirësuar bashkëpunimin dhe rrjetëzimin me organizatat e tjera duke:

1. Promovuar dhe mbështetur aktivitete në rrjet të cilat lehtësojnë shkëmbimin e informacionit dhe të eksperiencave mes INFOCIP-s me aktorë të tjerë.
2. Përmirësuar komunikimin me stafin, përfituesit e projekteve, e mbështetës të tjerë, si një strategji që siguron që gjithsecili të ketë informacionin e duhur mbi projektet dhe aktivitetet e saj.
3. Përmirësuar koordinimin midis INFOCIP-s dhe organizatave të tjera, veçanërisht me ato që kanë fusha të njëjta / ngjashme veprimi dhe përfituesish. Kjo do të ulë konkurrencën, reduktojë dublikimet e aktivteteve dhe do të rrisë efikasitetin në përdorimin e burimeve.
4. Zhvillojë strategji për të përmirësuar koordinimin midis INFOCIP-s dhe organizatave të tjera. Përmirësim i koordinimit nuk do të thotë shtypje e pavarësisë institucionale të secilës organizatë, e të drejtave dhe lirisë së saj për të shprehur e vepruar.

➤ **PËRFAQËSIMI NË NIVEL KOMBËTAR, RAJONAL E NDËRKOMBËTAR**

Përfaqësimi i INFOCIP-s në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar do të bazohet në mandatin e INFOCIP-s dhe programin në fokus të saj.

INFOCIP do të konsultohet me përfaqësues të tjerë të sektorit për çështje kyçe në mënyrë që të sigurojë një përfaqësim sa më të gjerë të sektorit. Përfaqësuesit e INFOCIP-s në këto forume duhet të japin informacion në sektorë në lidhje me çështjet e diskutuara dhe që mund të ndikojnë në mënyrë direkte ose jo punën e sektorit.

Adoptuar me:

Firmosur nga:

AktinKreka, Bordi drejtues, anerat themelues

Valbona Pajo, Bordi Drejtues, anetare themeluese

Aldona Luari, Bordi Drejtues, anetare themeluese

Gerti Shella, Drejtor Ekzekutiv, themelues